

**URDHËR**  
**Nr. 697, datë 22.10.2021**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si më poshtë:
  - a) kontratat e lidhura nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, në cilësinë e botuesit me autorët e botimeve, do të nënshkruhen nga drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, z. Arben Dervishllari.
2. Kompetencat e drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen deri në një urdhër të dytë.
3. Në rast të mungesës së personit të përcaktuar në këtë urdhër, kompetencat do të ushtrohen vetëm nga drejtori i Përgjithshëm.
4. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**  
**Ardit Bido**